

Sfidat e Kosovës për qëndrueshmëri ekonomike

*Muhamet Mustafa**
*Alban Zogaj***

Përmbledhje

Ky punim trajton sfidat, politikat dhe mundësitë për ndërtimin e një ekonomie të shëndoshë në Kosovë, si një nga çështjet kryesore në periudhën pas statusore. Qëllimi i këtij punimi është të analizojë perspektivat për një zhvillim ekonomik të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të Kosovës, si dhe t'i identifikojë politikat dhe veprimet të cilat duhet të miratohen nga Qeveria e Kosovës dhe aktorët e tjerë, me mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar në Kosovë.

Fjalët kyç: qëndrueshmëri ekonomike, zhvillim ekonomik, qëndrueshmëri, mosbalancim makroekonomik, reforma ekonomike.

Hyrje

Një vend mund të jetë ekonomikisht i qëndrueshëm atëherë kur resurset njerëzore, fizike dhe ato financiare që janë në dispozicion, përdoren në mënyrë efektive për të siguruar rritjen ekonomike dhe mirëqenien e banorëve të tij. Mbështetja në resurset është e rëndësishme, mirëpo, përdorimi efektiv i këtyre resurseve për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe rritje të mirëqenies është edhe më i rëndësishëm. Procesi zhvillimor është i lidhur me një mori politikash, duke përfshirë këtu: financimin e zhvillimit dhe infrastrukturës publike, kornizën rregullative, intervenimin qeveritar dhe politikat industriale. Reformat e forta, të orientuara kah tregu dhe stabiliteti ekonomiko-politik kanë dëshmuar të jenë faktorë të rëndësishëm, sidomos për ekonomitë në tranzicion.

* Prof. dr. Muhamet Mustafa, udhëheqës i Institutit Riinvest.

** MSc. Alban Zogaj, drejtor i hulumtimeve në Institutin Riinvest,
alban.zogaj@riinvestinstitute.org

Hulumtimet dhe përvojat nga shumë vende sugjerojnë se rritja ekonomike sigurohet me përmirësime në arsim, cilësinë e menaxhimit financiar, tregun e hapur dhe disponueshmërinë e infrastrukturës publike. Në anën tjetër, ajo ulet me një ngarkesë të gjerë tatimore, me mungesë të politikave të favorshme për stabilitet makroekonomik (duke përfshirë proceset si: inflacioni, kurset shumë të larta të këmbimit valutor dhe krizat bankare) si dhe me kushte të pavolitshme të tregtisë. Një përzjerje e përshtatshme e politikave ekonomike, e shoqëruar me një rritje të kapaciteteve dhe cilësisë institucionale, do të gjenerojë një model të dobishëm për një rritje të vetë-qëndrueshme.

Pjesëmarrja e kufizuar e kosovarëve në qeverisje në vitet e fundit ka pasur efekte negative mbi rritjen ekonomike dhe qëndrueshmërinë e Kosovës. Mungesa e sovranitetit ngriti pasigurinë politike dhe zvogëloi mundësinë e zgjedhjes, gjë që kishte efekt negativ mbi ekonominë, për shembull, mbi pasigurinë e pronësisë dhe përdorimin e resurseve natyrore. Kosova mund të shfrytëzojë përparësinë konkurruese të burimeve njerëzore dhe natyrore, dhe të demonstrojë zhvillim ekonomik. Sa i përket resurseve, Kosova nuk ka mungesë të tyre krahasuar me vendet fqinje. Sidoqoftë, përveç statusit politik të Kosovës, nevojitet përmirësim edhe në qeverisje, në sundim të ligjit, në infrastrukturën arsimore dhe publike, prandaj këta janë faktorët kritikë për krijimin e një ekonomie të qëndrueshme dhe të besueshme. E tërë kjo do të kontribuojë në një ambient më të mirë për investime, gjë që do t'i mobilizojë resurset lokale dhe ato nga diaspora, si dhe Investime e Jashtme Direkte (IJD), dhe do t'i shndërrojë ato në investime. Veç kësaj, është me rëndësi të sigurohet një rritje e madhe e GDP-së pas vitit 2009 (rritje prej 7-9%), për të krijuar hyrje të reja në tregun e punës dhe për të zvogëluar nivelin e lartë të papunësisë. Një rritje dinamike është, po ashtu, parakusht për trajtimin e konfiguracionit të de-balancimeve makroekonomike si për shembull: de-balancimi ndërmjet GDP-së dhe konsumit, deficitit i lartë tregtar, de-balancimi në tregun e punës dhe shuma e buxhetit krahasuar me investimet e nevojshme kapitale.

Pavarësisht nga fakti se Kosova, si një shtet i ri, që është në zhvillim e sipër, është relativisht mirë i pajisur me resurse, përballet me shumë sfida për të arritur dinamikat e nevojshme

të zhvillimit ekonomik. Problemet strukturore të tilla si: mungesa e infrastrukturës së duhur publike, niveli i lartë i papunësisë, dez-industrializimi dhe deficit i tregut, i cili rrjedh nga trashëgimia e vështirë (sidomos gjatë viteve 1990), kërkojnë edhe më tej mbështetje nga komuniteti ndërkombëtar përmes ndihmës teknike dhe financiare, si dhe bashkëpunim më efektiv. Për shkak të problemeve të saj strukturore dhe duke u bazuar në përvojat e deritashme, mund të pretendohet që Kosova do të ballafaqohet me vështirësi të mëdha në një periudhë afatmesme, në sigurimin e investimeve kapitale publike. Prandaj, mbështetja e institucioneve dhe donatorëve ndërkombëtarë është e nevojshme në këtë segment. Destinimet kryesore për mbështetje të mëtutjeshme mund të jenë: mbështetja në ndërtimin e kapaciteteve, në veçanti në fushën e zhvillimit të menaxhimit dhe qeverisjes; ndihma financiare në ballafaqimin me vështirësitë aktuale buxhetore për investim publik (posaçërisht në periudhën afatmesme), si dhe mbështetja në krijimin e marrëdhënieve gjithëpërfshirëse me institucionet financiare ndërkombëtare.

Rritja ekonomike nuk ndodh rastësisht, por është një përgjigje, ndër të tjera, për cilësinë e politikave publike, posaçërisht për ato që ndikojnë në investime, produktivitet, inovacion teknologjik dhe në efektin e jashtëm. Përderisa rritja e prodhimit kontribuon në zhvillimin njerëzor, rritja e cilësisë së lartë kërkon qasje të barabartë në mundësitë e ofruara për arsim, shëndetësi dhe gjenerim të të ardhurave për të gjithë qytetarët. Procesi i rritjes shoqërohet me një spektër të gjerë të politikave duke përfshirë këtu zhvillimin financiar, infrastrukturën publike, kornizën rregullative, intervenimin qeveritar dhe politikat industriale. Reformat e forta të orientuara drejt tregut dhe arritjet e stabilitetit ekonomik dhe politik janë faktorë kyç në ekonominë në tranzicion.

Qëndrueshmëria ekonomike: Teoria dhe përvojat

Në ekonominë globale, e cila po rritet gjithnjë e më tepër, vendet në zhvillim përballen me sfida të mëdha në sigurimin e rritjes ekonomike, dhe atë në veçanti për shkak të kursimeve

dhe investimeve të papërshtatshme, fuqisë punëtore me nivel të ulët të arsimit dhe aftësive, përkeqësimit të kushteve të tregtisë si dhe institucioneve të dobëta.

Kohët e fundit, vendet e Azisë Lindore, si Kina, ekonomitë "tigër" (Koreja e Jugut, Singapori, Tajvani, Tajlanda¹), si dhe vendet anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), kanë përjetuar një zhvillim afatgjatë. Megjithatë, ekzistojnë dy pikëpamje të kundërta për forcat kryesore shtytëse. Njëra pikëpamje konsideron akumulimin e kapitalit së bashku me rritjen e cilësisë (në vend të produktivitetit) të fuqisë punëtore si faktor kryesor, ndërsa tjetra e konsideron asimilimin ose blerjen dhe zotërimin e teknologjive të huaja si faktorin kryesor. Faktori Total i Produktivitetit (TFP), që është pjesa fizike e prodhimit, dhe kanalet përmes të cilëve kapitali njerëzor ndikon në prodhim, luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm. Në rastin e Azisë Lindore shumë do të bien dakord se akumulimi i kapitalit ishte më tepër forcë shtytëse e rritjes ekonomike se sa Faktori Total i Produktivitetit. Sidoqoftë, progresi afatgjatë është me rëndësi dhe Faktori Total i Produktivitetit konsiderohet si burimi më i rëndësishëm i rritjes ekonomike. Në përputhje me rrethanat, kombinimi ideal për të siguruar rritje ekonomike do të ishte akumulimi i kapitalit në një periudhë afatmesme dhe progresi teknologjik në një periudhë afatgjate.

Përfundimet kryesore të një studimi të fundit, të titulluar "Burimet e Rritjes Ekonomike": Një Vështrim i Përgjithshëm², i bazuar në një analizë gjithëpërfshirëse ekonometrike mbi përvojat e 78 shteteve, mund të përmbliidhen në dy tituj: politikat strukturore dhe institucionet, shkaqet dhe karakteristikat e rritjes ekonomike. Sipas këtij studimi, qeveritë mund të ndikojnë në zhvillimin afatgjatë përmes politikave strukturore, politikave për stabilizim dhe institucioneve.

¹ S. Iwata/M.S. Khan/H. Murao: *Sources of Economic Growth in East Asia: A Nonparametric Assessment*. In: *IMF Staff Papers* 50 (2003) 2.

² N. Loayza/R.Soto: *The Sources of Economic Growth: An Overview*. (2002).

Politikat kryesore për zhvillim të qëndrueshëm janë:

- a) Arsimi dhe formimi i kapitalit njerëzor, të cilat kanë ndikim në efikasitetin e llojeve të tjera të kapitalit dhe lehtësojnë përvetësimin e teknologjisë (matet nëpërmjet normave të regjistrimit);
- b) Cilësia financiare, zhvillimi i tregjeve financiare (matet përmes raportit të kredive private vendore krahas GDP-së);
- c) Hapja e tregtisë ndërkombëtare, e cila ka një ndikim në nivelin e konkurrencës, tregut, inovacionit teknologjik dhe gjithashtu në nivel të TFP-së (matet përmes raportit të vëllimit tregtar krahas GDP-së);
- d) Ngarkesa e qeverisë (matet përmes raportit të buxhetit krahas GDP-së);
- e) Disponueshmëria e shërbimeve publike dhe infrastruktura;
- f) Qeverisja (kapaciteti dhe cilësia institucionale, mungesa e korrupsionit, përforsimi i kontratave, ligji dhe rendi).

“A mund të jetë Kosova ekonomisht e qëndrueshme?”

Kjo pyetje e cila ishte ngritur shpesh në kontekstin e statusit politik, është shumë e rëndësishme dhe vë në diskutim të drejtpërdrejtë realizueshmërinë e një Kosove të pavarur, si dhe në anën tjetër cilësinë dhe dinjitetin e jetës së kosovarëve, në veçanti. Kjo çështje zakonisht është ngritur në lidhje me madhësinë e Kosovës (popullatës dhe vendit), resurset natyrore të saj dhe potencialin e pranishëm si dhe nivelin e zhvillimit. Megjithatë, ka dëshmi të shumta që madhësia si e tillë (sa i përket popullatës dhe vendit) si dhe burimet natyrore nuk kanë qenë një faktorë vendimtar për të siguruar ekonominë e qëndrueshme (siç kanë treguar rastet në Hong Kong, Lichtenshtein, Luksemburg, Monako dhe Singapor).

“Kush do të sigurojë qëndrueshmëri ekonomike në Kosovë nëse jo vetë kosovarët?” – mund të jetë përgjigja virtuale e kosovarëve. Dëshmitë historike sugjerojnë se mirëqenia dhe rritja ekonomike e Kosovës kanë qenë proporcionale me mundësinë e cila iu dha kosovarëve për t’i qeverisur vetë punët e tyre edhe për sa i përket nivelit të stabilitetit politik. Në

situatën e pas-luftës - nën administrimin e UNMK-ut - pjesëmarrja e kufizuar e kosovarëve në qeverisje dhe mungesa e kapaciteteve të qeverisë ka pasur efekte negative mbi rritjen dhe qëndrueshmërinë ekonomike. Qeverisja dhe sovraniteti janë të ndërlidhura ngushtë, meqë pa sovranitetit është vështirë të ndërtohen institucionet qeveritare dhe të arrihet sundimi i ligjit, pastaj edhe pronësia dhe menaxhimi i përgjegjshëm i resurseve. Të gjitha këto janë të rëndësishme për investime afatgjata në rritje, duke përfshirë këtu edhe zhvillimin institucional dhe atë njerëzor. Mungesa e sovranitetit ngrit pasigurinë politike dhe e zvogëlon mundësinë e zgjedhjes. Në pikëpamje ekonomike, efektet negative përfshijnë: pasigurinë në lidhje me pronësinë dhe përdorimin e resurseve natyrore (midis tyre edhe tokën dhe mineralet) për pasuri publike dhe prona shoqërore, e cila në fakt ishte vonuar, ndër të tjera privatizimi i tyre; vështirësi në zbatimin e legjislacionit financiar dhe ekonomik; fushëveprim i kufizuar për bashkëpunim me institucione rajonale dhe ndërkombëtare (si p.sh. me Organizatën Botërore të Ekonomisë (WTO), Bankën Botërore (WB), Fondin Monetar Ndërkombëtar (IMF) dhe BE-në, të gjithë këto janë pengesa për zhvillimin e marrëdhënieve tregtare me vende të tjera, për mobilizimin e kursimeve vendore dhe nga diaspora si dhe për tërheqjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta.

Pas përfundimit të suksesshëm të fazës fillestare në rindërtim dhe një bumi në ndërtim, UNMIK-u dhe Institucionet e Përkohshme të Vetë-Qeverisjes (PISG) nuk kanë qenë në gjendje të krijojnë një ambient politik dhe kushte për një rritje të qëndrueshme dhe afatgjatë të ekonomisë. Baza ligjore për biznes dhe tregti tashmë është krijuar, e cila kryesisht i përmbush standardet për ndërtimin e një ekonomie tregtare të hapur dhe bashkëkohore. Megjithatë, mekanizmat për zbatim nuk janë ende në fuqi dhe progresi i implementimit nuk është analizuar mjaft, për shembull në lidhje me detyrimet kontraktuale. Në pjesën veriore të Kosovës si dhe në enklavat e pakicave nuk ka pëlqim të ligjit të EULEX/Kosovës dhe asnjë hap nuk është ndërmarrë për të arritur pajtueshmëri. Këto dështime kanë efekte dërmuese në treg dhe ndikim negativ mbi mjedisin e biznesit dhe në atë të sundimit të ligjit. Sondazhet

me ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM)³ të bëra gjatë viteve 2000 dhe 2008, tregojnë se pronarët dhe menaxherët e NVM-ve konsiderojnë si pengesa kryesore, (në mes të 14 arsyeve të listuara) konkurrencën e pandershme (të pabarabartë), legjislacionin e pamjaftueshëm, korrupsionin, taksimin dhe qasjen e kufizuar në financa për kryerjen e biznesit. Të gjithë këta tregues janë tipikë për një mjedis turbulent të biznesit me një mungesë të kapacitetit dhe angazhimeve për zbatimin e sundimit të ligjit. Rritja e kapaciteteve, krijimi i përgjegjësisë për implementimin e ligjeve ekzistuese dhe sigurimi i sundimit të ligjit duken të jenë faktorë shumë kritikë për përparime të mëtejshme në ndërtimin e një mjedisi të favorshëm për rritjen ekonomike.

Transaksionet financiare të bazuara në Euro kanë kontribuar pozitivisht në stabilitetin makroekonomik të Kosovës. Megjithatë, stabiliteti makroekonomik afatmesëm dhe ai afatgjatë është i rrezikuar nga de-balancimet kritike, duke përfshirë këtu: de-balancimet në mes të GDP-së dhe konsumit, deficitit tregtar shumë i lartë, de-balancimet në tregun e punës dhe shuma e buxhetit krahasuar me investimet kapitale të nevojshme.

Konsumi total, sipas vlerësimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar, është 8-9% më i lartë se GDP-ja, i cili mbulohet kryesisht me paratë e dërguara nga kosovarët që jetojnë jashtë vendit. Së dyti, deficitit tregtar është shumë i lartë, me eksporte të cilat e mbulojnë vetëm një pjesë të vogël të importeve, për shembull në vitin 2004 rreth 5%, në vitin 2007 afro 10%, ndërsa në vitin 2008 afro 11%. Kjo situatë është një rezultat i kolapsit të plotë të strukturës industriale në vitet 1990 dhe i dez-industrializimit, i cili ka ndikuar shumë në eksport. Ndërmjet viteve 1991 dhe 1998 eksportet (duke mos llogaritur tregtinë me entitete të tjera jugosllave) kanë rënë dukshëm prej 212 milion USD në 38 milion USD. Sidoqoftë, trajtimi i këtij deficitit të madh varet nga implementimi i suksesshëm i politikave integruese të cilat çojnë në zhvillimin e bizneseve që të jenë në gjendje të konkurrojnë në tregun vendor, si dhe në zhvillimin e

³ Riinvest: SME Development – Annual Report 2003, 2004, (2004). Riinvest Institute: “SME Financing and Development,” Research Report, 2001, (2002). Riinvest: SME Development in Kosova-2000 (Annual Report 2000), (2001).

eksporteve duke përfshirë investime të huaja por edhe privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore.⁴ Së treti, nivelet e tashme të rritjes nuk tregojnë ndonjë perspektivë të mjaftueshme për të krijuar vende të punës për fluksin neto vjetor të rreth 25,000 punëkërkuesve të rinj në tregun e punës. Ky është një problem afatgjatë (83.1 % e të papunëve në Kosovë janë të papunë për më shumë se një vit). Së fundi, Buxheti i Kosovës prej rreth 1.1 miliard euro llogaritet për afërsisht te jete rreth 32% të GDP-së, ndërsa, shpenzimet e tanishme janë mbuluar dhe kemi vetëm një rritje të ngadalshme të të ardhurave vjetore, ekziston gjithnjë e më shumë nevoja për financim të investimeve kapitale thelbësore. Ka një kërkesë të lartë për përmirësimin e infrastrukturës së transportit (veçanërisht në zonat rurale), e infrastrukturës publike për të mbështetur zhvillimin e biznesit dhe punësimit, si dhe investime për përmirësimin e cilësisë së arsimit. Të gjitha këto detyra paraqesin një sfidë serioze. Pavarësisht nga përparimi në ndërtimin e një buxheti të qëndrueshëm, të ardhurat vjetore nuk mund t'i bëjnë ballë kërkesës për investime kapitale. Kosova është një ekonomi e re me një mangësi serioze të trashëguar në infrastrukturën sociale dhe ekonomike. Nevojat duhet të përcaktohen sipas përparësisë dhe duhet të merren fondacione nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe nga ato rajonale po ashtu, si dhe nëpërmjet fondit të BE-së për procese të para-pranimit. Vonesat në trajtimin e investimeve kritike në infrastrukturën publike, duke përfshirë edhe arsimin, do të sjellin pasoja të rënda për investime private lokale si dhe për investime të jashtme direkte dhe, rrjedhimisht, për procesin e zhvillimit ekonomik.

Në anë tjetër, në mënyrë paradoksale, në llogaritë e qeverisë ekziston një grumbull i të hollave të pashpenzuara (suficit buxhetor) prej rreth 500 milion eurove (për vitin 2008). Kjo shifër tregon mangësi të mëdha në procesin e buxhetit dhe mungesë të kapaciteteve për të menaxhuar projekte të përgjithshme dhe veçanërisht projekte kapitale. Ky boshllëk duhet urgjentisht trajtuar nga qeveria, në mënyrë që kapacitetet

⁴ *Federal Statistical Office: Statistical Yearbook of Yugoslavia 2000, Federal Statistical Office, 2000.*

në dispozicion të vihen në vend të duhur për t'u bërë ballë kërkesave për investime të infrastrukturës publike. Infrastruktura ekzistuese publike mbulon, në rastin më të mirë, vetëm nevojat bazë të popullatës dhe ekonomisë. Furnizimi me energji elektrike nuk është i sigurt për shkak të ndërprerjeve të shpeshta dhe importeve të konsiderueshme, pavarësisht nga fakti që Kosova është, së paku potencialisht, furnizuesi me kosto më të ulët në rajon. Deficiti ekzistues i furnizimit së bashku me rinisjen e aktiviteteve në miniera dhe shkrirje dhe potenciali për eksport të energjisë elektrike kanë rezultuar me propozime për rehabilitim të Kosovës, duke ndërtuar një termocentral të ri dhe një fabrikë të re prej 1000 MW së bashku me minierën e linjtit. Furnizuesi publik konkurren aktualisht me një kompani të re private të telekomunikacionit, por nuk është në gjendje të ofrojë një shërbim cilësor, ndërsa rrjeti celular është po ashtu një monopol virtual me çmime ndër më të lartat në Ballkan. Telekomunikacionet e dobëta dhe të shtrenjta, duke përfshirë edhe shërbimet e teknologjisë informative, janë parandalues serioz të biznesit dhe publicitetit i varfër për të nxitur zhvillimin e shërbimeve të cilësisë së lartë.

Ndërsa, infrastruktura e rrugëve kryesore i mbulon kërkesat bazë, rrugët anësore dhe ato rurale janë në gjendje shumë të dobët. Gjendja dhe kapaciteti i rrugëve kryesore, duke marr parasysh vëllimin e trafikut në këto rrugë, shkakton një ngritje prej 50-75% të humbjes së kohës se sa mund të pritët normalisht prej rrugëve të qyteteve kryesore për në Prishtinë, duke shkaktuar kështu pasoja serioze në shpenzime të transportit. Kosova aktualisht është lënë jashtë korridoreve trans-evropiane të trafikut. Përmirësime në korridoret kryesore Durrës - Prishtinë - Nish dhe Mitrovicë - Shkup janë të rëndësishme për të zvogëluar shpenzimet e transportit, për të rritur konkurrencën dhe për të lehtësuar integrimin rajonal dhe ndër-rajonal. Meqë 85% e popullatës kosovare jetojnë në një rreze prej njëzet kilometrave distance nga njëra prej shtatë qendrave kryesore, zhvillimi i rrjeteve të transportit inter-urban dhe sub-urban është më se i rëndësishëm për të mbështetur zhvillimin urban dhe rural. Përmirësime të këtilla të transportit do të ndihmonin një shfrytëzim më produktiv të resurseve në zonat rurale dhe zvogëlimin e trendëve të migrimit të brendshëm në qytete.

Nevoja për rritje ekonomike

Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF) si dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) kanë vlerësuar që shkalla e rritjes e GDP-së⁵ në vitin 2007 ishte 3.5 për qind, (e ngjashme me 2006). Edhe pse kjo tregon një përmirësim në krahasim me periudhën 2004–2005, ky nivel i rritjes ekonomike qëndron akoma shumë mbrapa vendeve të tjera në rajon⁶. Një nivel i tillë është i pamjaftueshëm për të kapërcyer shkallën e lartë të papunësisë dhe varfërisë në Kosovë si dhe de-balancimet tjera në konfigurimin makroekonomik të shtetit. Shkalla e arritur e rritjes ekonomike ka ndodhur kryesisht për shkak të investimeve në sektorin privat, i cili ka qenë i mbështetur nga investimet e jashtme direkte (IJD) dhe kredive të sektori bankar. Pra, ekziston nevoja për forcim të kuadrit të politikave për të tërhequr IJD-të (Investimet e Jashtme Direkte) dhe me shume investime private vendore, meqë ky do jetë burimi kryesor i krijimit të vendeve të punës. MEF dhe FMN kanë vlerësuar për vitin 2008 një rritje të GDP-së reale prej 5.4 për qind. Kjo rritje është bazuar kryesisht në rritjen e konsumit, investimeve, shpenzimeve qeveritare, ndihmave të huaja dhe eksportit. Tabela 1 i paraqet treguesit kryesor të makroekonomisë, në bazë të cilës mund të shihet se ekziston një projeksion i rritjes në të gjitha këto kategori. Megjithatë, duke pasur parasysh situatën aktuale, ky projeksion është sfiduar seriozisht.

Tabela 1. Disa indikatorë të rëndësishëm makroekonomikë

Indikator	2006 (est.)	2007 (est.)	2008 (proj.)	2009 (proj.)
GDP (milion €)	3,099	3,343	3,739	4,029
Rritje reale e GDP (%)	3.1	3.5	6.0	5.2
GDP për capita (€)	1,476	1,573	1,729	1,832
Inflacion (%)	2.0	10.4	2.5	2.4
Eksporte (milion €)	284**	343*	405*	470*
Importe (milion €)	1,305	1,576	2,051*	2,175*
Konsumi		3,810*	4,161*	4,323*
Investime (% GDP)	23.0	27.2	30.9	28.9
Ndihmat e huaja (% GDP)	10.3	8.9	9.2	9.4

Burimi: *, Departamenti i Makroekonomisë, MEF; **, Banka Qendrore e Kosovës

⁵ *Mid-Term Expenditure Framework – Ministry of Economy and Finance*

⁶ *Albania 5% real growth, Macedonia 3.5% real growth, Serbia 6% real growth, Croatia 4.6% real growth (source: IndexMundi)*

Sipas një studimi të kryer nga Instituti Riinvest me 500 NVM në vitin 2008, edhe pse rreth 59 për qind të ndërmarrjeve presin kushte më të mira për biznes këtë vit, është vështirë të thuhet se do të ketë një rritje të investimeve private krahasuar me vitin e kaluar. Investimet e jashtme direkte mbesin ende modeste, ndërsa kreditë janë të shtrenjta dhe ende ekziston një mungesë e instrumenteve të tjera financiare, të tilla si *leasing*, *factoring* dhe fonde bilaterale.

Rritja e pritur e shpenzimeve qeveritare bazohet kryesisht në rreth 400 milion euro të akumuluar nga vitet e kaluara (suficit i akumuluar buxhetor). Nga shpenzimet e planifikuara për vitin 2008, qeveria ka mund të shpenzojë vetëm 29 për qind gjatë gjashtë muajve të parë. Konsumi privat, si komponent i rëndësishëm në krijimin e zhvillimit ekonomik, ka një pjesëmarrje të konsiderueshme në GDP-në e Kosovës, veçanërisht konsumi shtëpiak. Për arsye të efekteve të inflacionit, papunësisë dhe varfërisë, nuk mund të pritet një rritje e konsumit në një të ardhme të afërt. Dhe nëse kemi një nivel të njëjtë të inflacionit gjatë vitit aktual, atëherë kjo do të shkaktojë uljen e fuqisë blerëse dhe konsumit privat.

Trendët aktuale dhe struktura e bilancit tregtar të Kosovës mbeten mjaft të pafavorshme, me shumë pak mundësi për rritje të eksporteve, dhe si rezultat, edhe rritja ekonomike do të jetë më e ulët. Është, po ashtu, evident pesimizmi ekonomik (matur si përqindje e të intervistuarve të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me trendët aktualë ekonomikë), i cili kishte rënë dukshëm pas shpalljes së pavarësisë, ka filluar të rritet për tetë për qind, vetëm gjatë periudhës së fundit të vitit 2008 (Maj – Shtator 2008).⁷

Shkalla e papunësisë në Kosovë është vlerësuar të jetë rreth 40 për qind, dhe mbetet një shqetësim kryesor i krijuesve të politikave. Është e domosdoshme, para së gjithash, për të forcuar përkushtimin ndaj sundimit të ligjit dhe për të siguruar një shkallë të rritjes të qëndrueshme afatgjatë prej rreth shtatë për qind. Vetëm nën këto kushte, mund të krijohet hapësira e nevojshme për të zbutur nivelin e lartë të papunësisë dhe të

⁷ This indicator is measured from the data gathered by Riinvest Institute, in the frame of the Early Warning Report

varfërisë. Sipas disa sondazheve të fundit në Kosovë, problemi i papunësisë është konsideruar të jetë një nga shqetësimet më të mëdha.⁸ Vlerësimet e fundit të Bankës Botërore tregojnë se rreth 45 për qind e popullsisë jetojnë në varfëri relative (konsumon më pak se 2 USD në ditë), dhe rreth 15 për qind e popullsisë jetojnë në varfëri ekstreme (konsumon më pak se 1 USD në ditë).⁹ Trendët ekonomikë të përjetuar gjatë gjashtë muajve të parë vitit 2008 nuk duket që tregojnë ndonjë pikë kthyesë drejt një rritjeje ekonomike, pavarësisht nga parashikimet dhe vlerësimet optimiste.

Siç shihet qartë në tabelën e parë (1) ka pasur një rritje të eksporteve gjatë vitit 2007, dhe parashikimet thonë se ky trend do të vazhdojë, por në anën tjetër ka ende një deficit të madh tregtar. Aktualisht në ekonominë e Kosovës, eksportet mbulojnë vetëm rreth njëmbëdhjetë për qind të importit, dhe shkaktojnë një deficit tregtar prej 30 për qind të GDP-së. Si pasojë e situatës politike në të kaluarën, një pjesë e popullatës kosovare ka migruar në shtetet perëndimore. Aktualisht, është llogaritur se rreth 17 për qind të totalit të popullatës jetojnë jashtë Kosovës. Sipas një studimi të Riinvestit mbi diasporën dhe remitancat, shumica e emigrantëve u dërgojnë para familjeve të tyre. Këto para përbëjnë gati 14 për qind të GDP-së. Pas luftës së vitit 1999 në Kosovë, zhvillimi i ekonomisë në bazë të donacioneve dhe parave të dërguara nga diaspora, u shfaq dukshëm në rindërtimin e shtetit. Por, duhet të theksohet se të dyja, ndihmat e huaja dhe remitancat dërguara në përgjithësi janë tani në rënie.

Siç u diskutua më parë, edhe pse rindërtimet e pasluftës ishin kryesisht të suksesshme, Kosovës i duhet akoma kohë për të krijuar një rritje të qëndrueshme. Mbeten edhe shume sfida – 40% e fuqisë punëtore, e cila është në rritje të shpejtë, është e papunë, shumica e tyre afat-gjatë meqë perspektivat për punë janë të vogla, niveli i arsimit të fuqisë punëtore dhe kapaciteti i arsimit të lartë janë të papërshtatshme. Ekziston një bilanc negativ tregtar, eksportet janë të papërfillshme, infrastruktura ekonomike dhe sociale është në përgjithësi e

⁸ *Early Warning Report 20 and 21, UNDP Kosovo*

⁹ *World Bank report on Poverty in Kosovo (Tetor, 2007)*

papërshtatshme dhe shpesh në gjendje të keqe, investimet janë të ulëta, 25-26% të GDP-së, ndërsa konsumi është i madh; pjesëmarrja e vlerësuar e bujqësisë në GDP është 25%, rreth 60% te GDP-se e krijojnë shërbimet kurse industria pjesën tjetër rreth 15%. Këto sfida strukturore dhe shpërpjesëtime mund të zgjidhen vetëm me një rritje të fortë afat-gjatë të ekonomisë.

Disa vende të Evropës Qendrore dhe Jug-Lindore, kanë arritur norma të larta të rritjes gjatë periudhave të tranzicionit, Kosova duhet të jetë në gjendje të barabartë për t'i bërë ballë sfidave të përshkruara më lart. Këto vende kanë arritur sukses kryesisht, për shkak të proceseve efektive të liberalizimit, duke rritur përparësinë e tyre konkurruese, si dhe duke krijuar një mjedis të favorshëm për biznes. "Çka nëse?" këta tre skenarët e rritjes (te cilët do të prezantohen në vazhdim) janë të bazuar në kushtet aktuale dhe mësimet e mësuara nga përvoja në ekonomi të tjera në tranzicion me rritje të lartë, duke përfshirë faktorët kyç të cilët kanë ndikim në rritjen e investimeve dhe konkurrencës. Skenarët janë të varur nga zhvillimet politike dhe institucionale dhe nga përmirësimet të tjera në mjedisin politik dhe ekonomik, dhe prandaj skenarët në vijim janë ndërtuar duke përdorur këta faktorë.

I ashtuquajtur "status quo skenar" me anë të së cilit pritet një ngecje e rritjes ekonomike, ose një rritje e ulët prej 1-3% nëse do të ketë probleme me statusin politik të Kosovës, ose nëse ka ndryshime në lidhje me reformat ekonomike dhe të qeverisjes. Pasojat e këtij skenari do të pasqyroheshin në një rritje të jo stabilitetit politik dhe ekonomik. Përveç kësaj, presioni për të emigruar do të rritej, dhe institucionet nuk do të ishin në gjendje për të trajtuar papunësinë dhe varfërinë. Ndoshta skenari i rritjes prej 5% do të kapërcejë shumë nga aspektet e përshkruara më lart, por nuk do të jetë i mjaftueshëm as për të gjeneruar nevojën shumë të madhe për vende të punës e as nuk do ta rrisë pozicionin konkurrues të Kosovës. Skenari i fundit tregon një shkallë të rritjes prej 7%, shkallë që do të linte hapësirë për trajtimin e problemit kronik të papunësisë dhe de-balancimeve të tjera makroekonomike.¹⁰

¹⁰ *Towards economic viability of Kosovo – challenges, policies and opportunities* - Rinvest Institute, 2006

Është e qartë se rritja e qëndrueshme ekonomike në Kosovë nuk ka gjasa të jetë e shtyrë nga vetëm një sektor ose nga ai i industrisë, por duke shfrytëzuar mundësitë e disa sektorëve, këta në vijim konsiderohen të kenë potencialin më të madh. Në sektorin e bujqësisë, bujqit, duke i dhënë fermtat e tyre të vogla dhe vendet, po largohen nga fushat e tyre të drithit dhe produkteve të tjera me vlerë të ulët, për prodhimin e produkteve me vlera të larta, të tilla si frutave, perimeve, dhe mishit, pra, aty ku ekzistojnë më shumë mundësi të tregut. Disa produkte me markë mund gjithashtu të zhvillohen për eksport, sidomos nëse do të përdoren disa programe mjedisore dhe ekologjike për ushqim të shëndetshëm.

Aktualisht, sektori i NVM-ve është me rëndësi jetike, dhe ka potencial për zhvillimin të mëtejshëm meqë mjedisi i biznesit po përmirësohet. Në kuadër të këtij sektori, agro-industria është tashmë e angazhuar në zëvendësimin e importit brenda tregut vendor, si dhe ka filluar të eksportojë në vendet fqinje (p.sh., qumësht, mish dhe lëngje) me një hapësirë për zgjerim. Në mënyrë të ngjashme, edhe furnizuesit e materialit ndërtimor si dhe industria e ndërtimit me shërbime përkatëse, kanë hapësirë të konsiderueshme për zgjerim në një ekonomi në rritje. Në një fazë të mëvonshme, bazuar në zgjerimin dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë dhe terciar, mund të ketë mundësi të larta për krijimin e shërbimeve të cilësisë së lartë. Mundësi për këto shërbime, ekzistojnë për shembull në sektorin teknologjisë informative dhe në atë financiar. Gjithashtu edhe turizmi, veçanërisht ai i dimrit dhe i skive duhet të konsiderohen dhe të hulumtohen.

Në sektorin e energjisë aktualisht janë duke u zhvilluar propozime për të mbuluar mungesat e mëdha të energjisë rajonale, si rehabilitimi i një termocentrali ekzistues dhe ndërtimi i një ose më shumë centraleve të mëdha të rinj, të cilat drejtohen në rezervat e bollshme relativisht të kualitetit të lartë, dhe me kosto të ulët të linjtit në Kosovë. Duke pasur parasysh nivelin e lartë të investimeve të kërkuara (disa miliarda euro për termocentralin, minierat, sistemet e transmetimit etj.) dhe kompleksitetin teknik të projektit, faza e parë e një zhvillimi të tillë do të zgjasë për një periudhë prej së paku shtatë deri në tetë vjet me përfitime thelbësore afatgjata, pastaj edhe në aspektin e punësimit dhe eksporteve. Ajo gjithashtu do t'u

sigurojë bizneseve kosovare me kosto të ulët, burim të besueshëm të energjisë. Megjithatë, edhe në afat të shkurtër, le të themi brenda dy deri në tre vjet, aktivitetet e ndërtimit dhe shërbimeve të tjera do të sjellin përfitime të rëndësishme në aspektin e punësimit. Zhvillimi do të përfshinte edhe IJD-të në shkallë të madhe.

Ekspluatimi dhe përpunimi i mineraleve dhe i metalit është po ashtu një sektor potencial i rritjes ekonomike. Privatizimi i fundit i ndërmarrjes Feronikel me IJD ka bere të mundur rifillimin e eksporteve. Ekziston një potencial për rindërtim të minierave dhe uzinave të shkrirjes të metalit - plumb, zink, nikel dhe mangan - që aktualisht kanë pushuar së prodhuari, duke përfshirë minierat e Trepçës në Stantërg, Kizhnicë, Novobërdë, dhe Hajvali. Megjithatë, shkalla potenciale dhe realizueshmëria komerciale e rinisjes së punës në miniera dhe shkrirje nuk është e qartë. Privatizimi është një parakusht për rifillimin e mundshëm, po ashtu edhe realizueshmëria komerciale, e cila do të përfshijë investimet kapitale substanciale nga Investimet e Jashtme Direkte. Metalet ishin ndër produktet kryesore të eksportit të mëparshëm të Kosovës. Prodhimi i llamarinës së zinkëtuar dhe rifillimi punës në Feronikel ishin paralajmërim i mirë, por efektet e krizës globale kanë ndikuar negativisht në këto kompani kohëve të fundit. Mund të ketë hapësirë për rifillim, ose rifillim të pjesshëm, për prodhim të eksportit (siç ishte rasti në vitin 1980) të produkteve të tjera metalike, si për shembull, pjesë të automobilave, elektro-motorë, radiatorë, letra të galvanizuara me zink, gypa dhe tuba, bateri dhe shirita të transportierit. Industrisë kosovare ka humbur në shumicën e këtyre tregjeve, por përmes bashkëpunimit me investitorët e huaj të këtyre tregjeve ai eventualisht do mund të rifitohet. Kjo varet kryesisht nga procesi i privatizimit, i cili do të ndihmojë sigurisht rritjen e eksporteve dhe rritjen ekonomike.

Si te bëhemi "Të favorshëm për investimet"?

Sipas skenarëve të paraqitur më sipër, është e qartë se faktorët që do të stimulojnë rritjen ekonomike do të varen shumë nga

efikasiteti i institucioneve demokratike si dhe nga sundimi i ligjit. Ndërkohë, do të ndihmojë statusi i zgjedhur i Kosovës në krijimin e një mjedisi më të mirë të investimeve, me qasje të rregullt në institucionet financiare ndërkombëtare dhe përmes mobilizimit të të gjitha burimeve të duhura, private dhe publike, vendore dhe ndërkombëtare të investimeve. Edhe pse investime të tilla janë të nevojshme nuk mjafton që të gjenerohet vet rritja e dëshiruar. Kushte të tjera ekonomike dhe institucionale duhen gjithashtu të jenë në vend, të tilla si ndryshime të nevojshme strukturore, kapacitete institucionale, kompetencat menaxheriale dhe punëmarrësit e aftë, së bashku me një aftësi për të planifikuar dhe zbatuar projekte.

Meqenëse edhe pas zgjidhjes së statusit të Kosovës, edhe ndihma teknike dhe financiare e komunitetit ndërkombëtar do të vazhdojë, të dy kushtet e përmendura më lart mund të arrihen. Kështu, ekonomia kombëtare, sipas të gjitha gjasave, do të varet nga aftësia e institucioneve dhe e burimeve njerëzore për të krijuar dhe absorbuar investimet, duke i transformuar ato në projekte të realizueshme dhe në një rritje të qëndrueshme ekonomike. Kjo do të jetë një pjesë përbërëse e imazhit të ri të Kosovës si një destinacion për IJD-te, e cila do të duhet të nxitet në mënyrë agresive.

Mjedisi i tanishëm i politikave (tatimore, financiare, etj.) është në përgjithësi, teknikisht dhe teorikisht i përshtatshëm. Megjithatë, politikat duhet të testohen përsëri kundër efekteve të tyre në rritjen ekonomike nën kushtet konkrete të Kosovës. Deri tani, kjo ka dëshmuar të jetë një problem. Në këtë drejtim është e nevojshme që të ri-konsiderohen tatimet dhe të bëhen të favorshme për investime (të gjitha mallrat për investime kapitale pa doganë, dhe periudhë më të gjatë kredituese në TVSH për pajisje). Së dyti, duhet të ndërmerren masa për rritjen e konkurrencës në tregun e kredive, në mënyrë që normat e interesit të bëhen të përshtatshme për investim afatgjatë, veçanërisht në aktivitetet prodhuese, aty ku prodhimet për eksport përfshihen (bashkëpunim me Institucionet Financiare Ndërkombëtare dhe banka për linjë të veçantë kreditore). Së fundi, duhet të zhvillohet reforma dhe ristrukturimi, kurse në shërbimet publike duhet të krijohet më shumë konkurrencë.

Skenar i preferuar (përshkruar më lart) tregon se deri në vitin 2010 buxheti i Kosovës duhet të jetë më shumë se 1.3 miliard euro. Nga pikëpamja ekonomike, një pjesë e buxhetit të konsumit prej 30 deri 32% të GDP-së nuk konsiderohet si një problem për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Megjithatë, në qoftë se shpenzimet tejkalojnë këtë nivel atëherë, në bazë të disa përvojave ndërkombëtare, kjo mund të ketë ndikim negativ në rritjen ekonomike.

Problemi më i dukshëm për buxhetin është se si të përballohen nevojat për investime kapitale. Disa nga këto kërkesa veç janë përshkruar më lart. Projektimet e Investimeve Kapitale të cilat janë hartuar në mungesë të një strategjie të zhvillimit nuk kanë qenë të bazuara në prioritete të përcaktuara mirë. Prandaj, Programi i Investimeve Publike , i cili është hartuar dhe miratuar nga qeveria, duhet të harmonizohet me Planin Zhvillimor afatmesëm të Kosovës dhe me objektivat kryesore të zhvillimit ekonomik, që aktualisht janë duke u përgatitur. Bazuar në përvojat e deritashme, mund të pritet që, për shkak të problemeve strukturore të saj, Kosova do të përballet me vështirësi në blerjen e investimeve kapitale publike në një periudhë afatmesme. Prandaj, mbështetja e Institucioneve Ndërkombëtare Financiare dhe donatorëve të tjerë në këtë fushë është e nevojshme. Një rritje e mëtejshme e shpenzimeve buxhetore do të jetë e nevojshme në të ardhmen. Për shembull, vende të reja pune do të krijohen për ministri të reja, ku harxhime për hapësirë të zyrave dhe shpenzime të tjera do të lindin.

Procesi i ristrukturimit i kompanive publike, të tilla si Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Posta dhe Telekomit i Kosovës (PTK), Aeroporti i Prishtinës, Hekurudhat, Ngrrohtorja rajonale, Ujësjellësi dhe kompanitë e ujërave të zeza, nuk kanë përparuar sipas projektimit buxhetor. Vartësia nga fondet buxhetore është një realitet për disa prej këtyre kompanive, ndërsa niveli i cilësisë së shërbimeve që ofrohen është shumë i ulët, edhe pse me kosto mjaft të lartë. Është e qartë se fondet buxhetore kompensojnë menaxhimin joefikas dhe vonesat në ristrukturimin dhe liberalizimin e këtij tregu. Një praktikë e tillë ka krijuar një paradoks, ku taksapaguesit paguajnë për të metat e menaxhimit. Veç kësaj, në sektorin e energjisë, kjo është

shoqëruar me një nivel të ulët të faturimit dhe pagesës së faturave të dërguara. Zgjidhja duhet të kërkohet në liberalizimin e industrisë së shërbimeve publike, duke krijuar kushte për investime private dhe një konkurrencë më të madhe në treg. Kjo do të shkarkojë buxhetin nga detyrimet e paarsyeshme dhe do të rriste përgjegjësinë e kompanive publike. Qeveria ka vendosur të privatizojë kompanitë publike deri në fund të vitit 2009, por ende nuk ka strategji të qartë dhe kornizë ligjore dhe gjithashtu i mungon mbështetja e duhur, duke filluar nga konsensusi bazë mes aktorëve kyç në këtë proces.

Ndihma teknike dhe bashkëpunimi

Përkundër faktit se Kosova është relativisht mirë e pajisur me burime, ajo ka një ekonomi në zhvillim dhe si e tillë ajo do të përballet me shumë sfida përpara se të mund t'i arrijë dinamikat e nevojshme për zhvillim ekonomik. Problemet e saj strukturore, të tilla si mungesa e infrastrukturës së duhur publike, papunësia, de-industrializimi dhe deficitit tregtar, pasoja të një trashëgimie të vështirë, sidomos gjatë viteve 1990, kërkon mbështetjen e vazhdueshme të bashkësisë ndërkombëtare përmes ofrimit të ndihmës financiare dhe teknike si dhe bashkëpunim.

Mbështetjet e ardhshme ndërkombëtare mund të sigurohen nëpërmjet disa kanaleve të ndryshme. Kosova ka nevojë për një ndihmë të mëtejshme teknike nga komuniteti ndërkombëtar, në mënyrë që të vazhdojë trendin e ndërtimit të kapaciteteve në fushën e qeverisjes, ekonomisë dhe financave. Megjithatë, duhet ndryshuar karakteri dhe vëllimi. Në këtë aspekt, transferimi i kompetencave duhet të vazhdojë edhe gjatë procesit të përcaktimit të statusit të vendit. Pasi që çështja e statusit është zgjidhur, të gjitha kompetencat e UNMIK-ut në fushën e ekonomisë dhe financave duhet të transferohen në institucionet e Kosovës. Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, kompetenca të plota mbi politikat fiskale, Autoritetin Bankar dhe të Pagesave, Trustin e Pensioneve, Agjencinë për Privatizim, administratën e doganave, ndërmarrjet publike si dhe marrëdhëniet e huaja ekonomike janë transferuar në institucionet kosovare. Sipas kësaj, duhet përgatitur një

vlerësim i nevojave për konsultim ndërkombëtar brenda këtyre institucioneve. Gjithashtu është e nevojshme përgatitja e një programi për trajnim intensiv për menaxhim makroekonomik dhe menaxhim financimit të zhvillimit. Roli monitorues i komunitetit ndërkombëtar, së bashku në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe FMN-në në këtë fushë në një periudhë të caktuar kohore, do të duhej të merreshin me zbatimin e ligjit dhe të zbatimit të përgjithshëm të standardeve ndërkombëtare, si dhe çështjet e të drejtave të njeriut. Një tjetër kanal i mbështetjes ndërkombëtare mund të jetë rritja e aftësive absorbuese për të shfrytëzuar fondet e premtuara në konferencën e donatorëve (2008), me anë të së cilit do mund të realizohej mbështetje për nevojat strategjike për zhvillimin ekonomik të Kosovës, veçanërisht për ato në infrastrukturën publike.

Deklarata e Pavarësisë se Kosovës është gjithashtu një faktor i rëndësishëm për përmirësimin e qeverisjes ekonomike, ngritjen e marrëdhënieve tregtare dhe ekonomike me vende të tjera, duke qenë një anëtar i Institucioneve Ndërkombëtare Financiare, dhe duke pasur bashkëpunim me ta dhe me organizata të tjera ndërkombëtare. Kosova është tani vend i pavarur i njohur nga 57 shtete nga e gjithë bota, dhe ajo duhet të marrë përgjegjësinë për realizueshmërinë e saj ekonomike duke e bazuar atë në një zhvillim të qëndrueshëm. Bashkësia ndërkombëtare, ka kontribuar drejt tejkalimit të pasojave të tmerrshme të luftës dhe në rindërtimin e shoqërisë kosovare, duke përfshirë ngritjen e një infrastrukture institucionale të bazuar në zgjedhjet e lira. Megjithatë, zhvillimi i mëtejshëm i këtyre institucioneve kërkon një tip të ri mbështetjeje, veçanërisht për të rritur kapacitetin e zbatimit të ligjit, qeverisjes dhe menaxhimit të zhvillimit. Gjithashtu, investimi i mëtejshëm për përmirësimin e cilësisë së arsimit do të kthehet me në ngritjen e kapaciteteve absorbuese të Kosovës për investime dhe zhvillim. Faza tjetër e kësaj ndihme duhet të drejtohet tërësisht në rritjen e kapaciteteve, në vend se faktorët e jashtëm t'i bëjnë punët që vetë kosovarët duhet t'i bënin.

Ndalja e zhvillimit dhe mungesa e investimeve në infrastrukturë dhe shërbimet publike gjatë viteve 1990 kanë pasur shumë pasoja negative për Kosovën, sidomos në kushtet

aktuale për zhvillimin. Buxheti i Konsoliduar i Kosovës do të përballlet me vështirësi, së paku në afat të mesëm, në sigurimin e investimeve të nevojshme deri sa të arrihet një rritje ekonomike dhe një përmirësim i administratës tatimore duke përmirësuar kështu mbledhjen e taksave edhe më tutje, të cilat do të forcojnë buxhetin. Mbështetja e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës do të kërkojë ndihmë të drejtpërdrejtë financiare ndërkombëtare në këtë fushë. Bashkëpunimi me FMN-në dhe BB-në, të cilët kanë qenë të pranishëm gjatë gjithë periudhës së pas luftës, ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme, me ndihmën teknike dhe dhënien e drejtpërdrejtë të buxhetit gjatë viteve të para.

Me avancimin e bisedimeve për statusin dhe finalizimin e tyre, pritjet të këtyre kapaciteteve të reja që do të krijohen për shkak të këtij bashkëpunimi. Momentalisht, të dy palët, e veçanërisht institucionet kosovare, duhet të punojnë në përgatitjen e projekteve të realizueshme dhe të kenë sisteme të duhura të administrimit për zbatimin e tyre. Lidhje me këtë, tashmë janë marrë disa nisma për krijimin e bashkëpunimit me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim si dhe me Bankën Evropiane të Investimeve, të cilat duhet të përforcohen. Bashkëpunimi me Institucionet Ndërkombëtare Financiare duhet të themelohet dhe të organizohet në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, dhe të qeverisë për shkak të rëndësisë thelbësore për ndërtimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm nëpërmjet rritjes ekonomike afatgjate.

Përktheu nga anglishtja: Dafina Vezaj

Referencat

- S. Iwata/M.S. Khan/H. Murao: Sources of Economic Growth in East Asia: A Nonparametric Assessment. In: IMF Staff Papers 50 (2003) 2.
- N. Loayza/R.Soto: The Sources of Economic Growth: An Overview. (2002).
- Riinvest: SME Development – Annual Report 2003, 2004, (2004). Riinvest Institute: “SME Financing and Development,” Research Report, 2001, (2002). Riinvest: SME Development in Kosova-2000 (Annual Report 2000), (2001).

Federal Statistical Office: Statistical Yearbook of Yugoslavia 2000,
Federal Statistical Office, 2000.

Mid-Term Expenditure Framework - Ministry of Economy and
Finance.

Early Warning Report 20 and 21, UNDP Kosovo.

World Bank Report on Poverty in Kosovo.

Trendet Riinvest 2008.